



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 20/30 Prot.

Tiranë më, 05/02/2024

V E N D I M

Nr. 11, datë 05/02/2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Klevis Dhigoi	Kryesues
Erjana Pjetri	Relatore
Ersa Karaj	Anëtare

në datën 05.02.2024, në orën 10:00, në ambientet e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Znj. Vilma Dashamir Ibrahim, me funksion aktual Shef Sektori, në Sektorin e Cilësisë së Informacionit Policor, në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatores së çështjes, znj. Erjana Pjetri, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
2. Në zbatim të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Agjencia e Mbrojtjes Policore vlerëson punonjësit në pozicionet e mëposhtme:
 - a) *Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, Drejtor Departamenti, Drejtor i Drejtorisë Qendrore, Drejtor në strukturat e veçanta, Drejtor e Zëvendësdrejtor vendor, Drejtor në Drejtoritë e Kufirit dhe Migracionit, Shef Komisariati, Shef Sektori në nivel qendror e vendor, që mbulon fushën e krimit të organizuar, krimit ekonomik/financiar dhe policisë rrugore në Policinë e Shtetit;*
 - b) *Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie dhe Shef Njësie në Gardën e Republikës;*
 - c) *Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie, Shef Sektori në nivel qendror dhe vendor në Agjencinë e Mbrojtjes Policore;*
 - d) *Punonjësit që do të emërohen në strukturën e vlerësimit kalimtar/periodik në Agjencinë e Mbrojtjes Policore;*
 - e) *Çdo punonjës që emërohet në pozicionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d”.*
3. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, znj. Vilma Dashmir Ibrahim, ka qenë subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit të saj si Drejtor, në Drejtorinë e Analizës dhe Informacionit Kriminal, në Departamentin e Policisë Kriminale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
4. Subjekti i vlerësimit, znj. Vilma Ibrahim, i'u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 07, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga z. Klevis Dhigoi (Kryesues), znj. Erjana Pjetri (Relatore) dhe znj. Ersa Karaj (Anëtare).
5. Subjekti i vlerësimit, znj. Vilma Ibrahim, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2, nenit 36, pika 1, dhe nenit 44, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, të cilat janë marrë në dorëzim nga relatorja e çështjes.
6. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me Vendimin nr. 1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së

Vlerësimet sipas nenit 27, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat procedural të unifikuar*”, me Vendimin nr. 1, datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit znj. Vilma Ibrahimimi.
8. Relatorja e çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar më datë 18.04.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, duke i bërë me dije përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
9. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 20.04.2023, duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
10. Relatorja e çështjes në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat procedural të unifikuar*”, nenit 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (këtu e në vijim ILDKPKI), ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat procedural të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat procedural të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
11. ILDKPKI, me shkresë nr. ***, prot., datë 26.10.2023, dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të vlerësimit znj. Vilma Ibrahimimi, në përputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
12. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, me shkresë nr. ***, prot., datë 23.08.2023, dërgoi raportin e kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit znj. Vilma Ibrahimimi, në përputhje me nenin 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
13. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresë nr. ***, prot., datë 30.06.2023, dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e vlerësimit znj. Vilma Ibrahimimi, në përputhje me nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
14. Në vijim relatorja e çështjes, bazuar në nenet 34, 42 dhe 46 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet përgjegjëse, duke kryer një hetim të plotë

dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe pika 12 dhe 14, nenit 3, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
16. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, më datë 26.01.2024, ka njoftuar Trupën e Vlerësimit, se subjekti i vlerësimit znj. Vilma Ibrahimimi, është transferuar dhe emëruar në detyrë me Urdhër nr. 228, datë 25.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me motivacionin “Për nevoja pune”.
17. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka vënë në dispozicion të Trupës së Vlerësimit, dokumentacionin si më poshtë:
 - Urdhër nr. 228, datë 25.01.2024, “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, me anë të të cilit znj. Vilma Ibrahimimi, është transferuar dhe emëruar në detyrën, Shef Sektori, në Sektorin e Cilësisë së Informacionit Policor, në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
18. Trupa e Vlerësimit, me shkresën nr. 405, datë 26.01.2024, është vënë në dijeni të urdhërit “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, që subjekti i vlerësimit znj. Vilma Ibrahimimi, ushtronte pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke u emëruar në një pozicion që nuk parashikohet në nenin 6, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, në kushtet kur nuk kishte marrë vendim përfundimtar për përfundimin e hetimit administrativ.

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

19. Trupa e Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, administroi dokumentacionin si vijon:
 - Urdhër nr. 228, datë 25.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
20. Nga verifikimi i akteve në terësi, Trupa e Vlerësimit konstaton se, ndodhemi në kushtet e transferimit dhe emërimit në detyrë të subjektit të vlerësimit, **nga funksioni** si Drejtor, në Drejtorinë e Analizës dhe Kartotekës, në Departamentin e Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, **në funksionin aktual** si Shef Sektori, në Sektorin e Cilësisë së Informacionit Policor, në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Urdhër nr. 228, datë 25.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Shtetit.
21. Për këtë arsye znj. Vilma Ibrahimimi:
 - *Nuk është subjekt i vlerësimit kalimtar, për shkak të pozicionit të saj të punës jashtë fushës së ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar (Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore), pozicion që nuk përcaktohet në pikën 1, të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

22. Në këto kushte, Trupa e Vlerësimit, në zbatim të nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, deklarohet të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur procedura, janë bërë ligjërish të pamundur.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprehen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit **Vilma Dashamir Ibrahim**, me funksion aktual Shef Sektori, në Sektorin e Cilësisë së Informacionit Policor, në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet znj. Vilma Dashamir Ibrahim, si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ky vendim u shpall sot më datë 05.02.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Klevis DHIGOI

Kryesues

Erjana Pjetri

Relatore

Ersa KARAJ

Anëtare